

AUTONOMIA

PUBLIKIM I SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE

VENDORE



autonomia
vendore



demokracia
lokale



decentralizimi



rritja e
kapaciteteve



zhvillimi
lokal



mbrojtja e
mjedisit



ARBJAN MAZNIKU

MINISTËR

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor ka si qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e qeverisjes vendore. Kjo siguron që politikat, reformat dhe projektet tona të përshpejtojnë procesin e integritimit evropian si dhe përgjigjen ndaj nevojave të komuniteteve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Teksa, integrimi në Bashkimin Evropian është synimi më i rëndësishëm që kemi përpara si dhe duke pasur parasysh se rreth 70% e legjislacionit evropian kërkohet të zbatohet në nivel vendor, roli i Shoqatës për Autonomi Vendore është kritik në këtë proces kaq gjithëpërfshirës për të ndërtuar një mjedis të shëndoshë dialogu duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe rritur bashkëpunimin mes dy niveleve të pushtetit.



ERION VELIAJ

KRYETAR

SHOQATA PËR AUTONOMI VENDORE

Transformimi i qyteteve tona mund të ndodhë vetëm nëqoftëse ne të gjithë arrijmë të krijojmë sinergji me qytetarët duke i parë ata si aksionerë të ndryshimit që duam të sjellim përmes investimit tonë të palodhur për t'i informuar, konsultuar e përfshirë ata në çdo hap të punës tonë. Është kjo e vetmja mënyrë sesi mund të ndërtojmë qytete funksionale, më të mira, më të jetueshme për çdo qytetar. Shoqata për Autonomi Vendore ka qenë në pararojë të transformimit të komunikimit me qytetarët dhe të krijimit të një modeli të ri qeverisje në partneritet me komunitetin dhe grupet e ndryshme të interesit. Unë jam krenar, që së bashku ia kemi dalë të krijojmë disa standarde të reja të bashkëqeverisjes me qytetarin duke kthyer idetë dhe kontributin e tyre në politika dhe vizion transformues për të ardhmen.




ADELINA FARRICI

DREJTORE EKZEKUTIVE

SHOQATA PËR AUTONOMI VENDORE


SHAV mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar me të gjithë aktorët lokal, qeverisjen qendrore dhe donatorët e huaj për të çuar përpara zhvillimin e kapacitetit të bashkive, autonominë vendore dhe demokracinë lokale, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe integrimin e tyre europian. Ne jemi të vetëdijshëm se bashkitë dhe shoqatat kanë një rol të veçantë dhe janë pjesë përbërëse në proceset zhvillimore dhe integruese për qytetet dhe vendin. Unioni ynë është instrumenti më i mirë në duart tona, i cili me peshën e tij unifikuese mundëson vemendje të shtuar, më shumë burime dhe kapacitete për zhvillim dhe mirëqenie lokale në bashkitë tona.



**SHKËMBIM PËRVOJASH ME SHOQATAT HOMOLOGE TË RAJONIT
SHTËPIA STUDIO KADARE**

PËRMBAJTJA

Mesazh	02
Rreth Nesh	07
Decentralizimi	09
Rritja e Kapaciteteve	11
Zhvillimi i Biznesit Lokal	12
Përfshirja Sociale	15
Mbështetja Komunitare	17
Advokimi i Pushtetit Vendor	19
Bashkëpunimi Ndërkombëtar	21
Raporte	24
Anëtarët	26
Partnerët	27





**MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHAV
TIRANË, 2022**

RRETH NESH

Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV) u themelua në 12 Janar 2010, si një bashkim vullnetar dhe i pavarur i Bashkive të Republikës së Shqipërisë, me misionin për më shumë autonomi vendore përmes forcimit e zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave demokratik në organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore.



Vizioni i SHAV mbetet forcimi i të drejtave dhe lirive të këtyre Njësive si një parakusht për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve lokale, duke qënë më pranë tyre përmes gjithëpërfshirjes dhe kompetencave në vendimmarrje.

Na kontaktoni:



Rruga Reshit Çollaku, Pallati 38 shkalla
2 ap. 13/1, Tiranë, Shqipëri



info@shav.al



www.shav.al



@shoqataperautonomivendore



autonomia_vendore

A group of approximately 15-20 people, mostly women, are gathered in a modern, wood-accented room with large windows. They are engaged in a meeting or presentation. The room has a high ceiling with exposed wooden beams and a dark, corrugated metal ceiling. Large windows on the right side offer a view of a green landscape. The floor is made of dark wood. The text "TAKIM KONSULTATIV ME SHOQATAT HOMOLOGE RAJONALE MAQEDONI" is overlaid in yellow at the bottom left.

**TAKIM KONSULTATIV ME SHOQATAT HOMOLOGE RAJONALE
MAQEDONI**



DECENTRALIZIMI

#Strategjia e Re e Decentralizimit 2023-2030

Shoqata për Autonominë Vendore (SHAV) ka qënë në mënyrë vazhdueshme pjesë e fushatave të konsultimit publik në kuadër të hartimit të Strategjisë së re të Decentralizimit të Republikës së Shqipërisë me aktorët kryesor të pushtetit vendor në vend.

Kjo nisëm erdhi si përgjigje ndaj procesit të udhëhequr nga Qeveria Shqiptare për hartimin e Strategjisë së re të Decentralizimit bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 76, datë 22.4.2022 “Për krijimin e grupit politik ndërinstitucional dhe grupit teknik të punës për hartimin e strategjisë ndëresektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore dhe planin e veprimit të saj, 2023-2030”, si dhe në vijim të shkresës nr. 3459 datë 9.5.2022 të Ministrisë së Brendshme “Kërkesë për përfaqësues”, ku shoqatat e pushtetit vendor janë anëtarë të grupit të punës politiko-teknik të strategjisë së decentralizimit.

Nisma ndihmojë në identifikimin e mangësive, sfidave dhe zgjidhjeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e politikave të decentralizimit dhe funksioneve të qeverisjes vendore. Gjetjet nga këto takime, kontribuojnë në hartimin me pjesëmarrje të rekomandimeve për Strategjinë e Re të Decentralizimit 2023-2030, të cilat gjithashtu do të përfshihen në një dokument publik.

Takimet konsultative ndihmuan në hartimit e vizionit të politikave 2023-2030 i parë nga perspektiva e Njëjësive të Qeverisjes Vendore, duke identifikuar boshllëqet e politikave dhe ofruar rekomandime për përmirësimin e tyre si dhe masat e propozuara shoqëruar nga objektivat në nivel të mundshëm.

Kjo nisëm mbështetet nga “Bashki të Forta”, një projekt i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, zbatuar në Shqipëri nga HELVETAS.

#DECENTRALIZIMI

KESHILLI I BASHKISE



TRAJNIM PËRGATITOR ME KËSHILLTARËT BASHKIAK
BASHKIA SHKODËR



RRITJA E KAPACITETEVE

#TrajnimPërKëshillatBashkiak

Viti që po lëmë pas ishte një vit zgjedhor për pushtetin vendor çka solli ndryshime në nivelin drejtues të bashkive përfshirë dhe konfigurime të reja në Këshillat Bashkiak. Për këtë arsye gjatë periudhës Shtator-Nëntor ka nisur cikli i "Trajnimit Përgatitor për Këshilltarët Bashkiakë". Qëllimi i trajnimit është njohja e këshilltarëve vendor me legjislacionin kryesor që rregullon veprimtarinë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri si dhe familjarizimi me njohuritë bazë që i nevojiten këshilltarëve për ushtrimin e detyrës së tyre, si të zgjedhur të komunitetit për t'i shërbyer atij. Ky trajnim është i rëndësishëm veçanërisht për ata këshilltarë që janë zgjedhur për herë të parë.

Trajnimi organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV), Shoqata e Keshillave te Qarqeve te Shqiperise(SHKQSH), ASPA - Shkolla Shqiptare e Administrates Publike dhe Projektit Bashki të Forta (BtF) i cili zbatohet nga Helvetas dhe financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Swiss Development & Cooperation).

#Turi i Takimeve Me Kryebashkiakët e Rinj

Pas konstituimit të kryebashkiakëve të rinj të vendit nisim turën e vizitave për vendosjen e komunikimit me ta, në funksion të angazhimit tonë për të asistuar të gjitha bashkitë e vendit duke mbrojtur të drejtat e tyre për autonomi vendore, demokraci lokale dhe gjithëpërfshirje në projektet zhvillimore për pushtetin vendor me aktorë të tretë kombëtar dhe ndërkombëtar.



ZHVILLIMI I BIZNESIT LOKAL



#Certifikimi i
Bizneseve Lokale

Në bashkëpunim me GIZ dhe NALED nisëm trajnimet me bashkitë mbi procesin e certifikimit miqësor për bizneset lokale.

BFC është një program për bizneset dhe investitorët që kërkojnë të zgjerojnë operacionet e tyre në Evropën Juglindore përmes vlerësimit paraprak të kushteve për investim në nivel lokal. Ai siguron një mjedis biznesi të qëndrueshëm, duke identifikuar qytetet dhe bashkitë që ofrojnë klimën më të mirë të investimeve dhe potencialin më të madh të zhvillimit.

Këtij programi i janë bashkuar 10 bashki të vendit që kanë për qëllim promovimin e potencialit ekonomik të zonave të tyre për investitorët e huaj.





#BIZNESI

#ADRIONET

Pas 36 muajsh punë intensive SHAV ka përmbyllur me sukses implementimin e projektit të Bashkimit Europian ADRIONET i cili u zbatua në tre bashki përfituese të vendit.

Projekti i koordinuar nga Rajoni Emilia-Romagna iu dedikua krijimit të rrjetit Europian të "fshatrave autentike" ku disa lokalitete të bashkisë Mirditë, Mat dhe Klos u bënë pjesë e këtij rrjeti ndërkombëtar që ka për qëllim të marketojë dhe të zhvillojë kapacitetet e tyre turistike në një periudh-afatgjate.

Projekti gjithashtu mundësojë rritjen e kapaciteteve të njësive vendore dhe bizneseve lokale përmes hartimit të Planin e Qëndrueshmërisë për promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të kulturës, identitetit, cilësisë së jetës dhe zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në këto zona rurale.

ADRIONET është një projekt i mbështetur nga programi Interreg ADRION i financuar nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal dhe IPA II.





AKTIVITET ME KOMUNITETIN NË ZONAT RURALE
MALI I VELËS, MIRDITË

PËRFSHIRJA SOCIALE


#Fuqizimi i Minoriteteve

SHAV në bashkëpunim me programin e GIZ për “Të Drejtat Sociale për Grupet Vulnerabël II” SoRi II dhe NALAS po punojnë për fuqizimin e minoriteteve përmes zbatimit të praktikave të strukturave të bashkive në Ballkanin Perëndimor (BP). Menaxhimi i diversitetit dhe modelet e pakicave në BP janë aktualisht në procesin e krijimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe afatgjatë me qëllim sigurimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike të të gjitha grupeve shoqërore dhe akses të barabartë në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (ESC) në përputhje me parimin gjithëpërfshirëse të programit të OKB “Askund të Mos Mbetet Pas”.



#Përfshirja Sociale dhe Migrimi

SHAV ka finalizuar dokumentin udhërrëfyesit “Për një pëfshirje Më Të Mirë Sociale në Nivel Lokal i cili përmban gjithashtu rekomandime për forcimin e kapaciteteve advokuese për adresimin e çështjeve të përfshirjes sociale në nivelet vendore. Qëllimi i këtij udhërrëfyesi është shndërrimi i rekomandimeve të tij në strategji konkrete e gjithëpërfshirëse të cilat do të zbatohen nga pushteti lokal. Në fokus të tyre është përfshirja sociale dhe menaxhimi i fenomenit të migrimit. Kjo sipërmarrje vjen në funksion të partneritetit rajonal “Bashkëpunimi Rajonal për Përfshirje më të Mirë Sociale në Nivel Lokal” mbështetur nga NALAS dhe GIZ.





**PROJEKTI “MJEDIS I PASTËR, ARSIM I SHËNDETSHËM E CILËSOR NË SHKOLLË”
GJIMNAZI “ISA BOLETINI”, KAMËZ**

MBËSHËTETJA KOMUNITARE

#BEpërBASHKITË



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE



#ASISTENCË

SHAV është pjesë e zbatimit të projektit “BE për Bashkitë”, financuar nga Bashkimi Evropian e që ka për qëllim mbështetjen e potencialit zhvillimor të bashkive dhe përmirësimin e kushteve socio-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve lokale në Shqipëri.



Qytetarët: projekti mbështet investimet të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetesës të komuniteteve lokale.



Organizata të Shoqërisë Civile: duke inkurajuar fuqizimin e komuniteteve vendore, projekti po kontribuon në lehtësimin e angazhimit të OSHC-ve në proceset zhvillimore vendore dhe në rritjen e ndërgjegjësimit në standardet e BE-së.



Qeveria Qendrore: projekti do të ofrojë asistencë për zbatimin e objektivave strategjike të reformës territoriale dhe të decentralizimit me synim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, promovimin e zhvillimit ekonomik në nivel vendor dhe uljen pabarazive zhvillimore territoriale.



Bashkitë: projekti po mbështet bashkitë nëpërmjet granteve për të përmirësuar infrastrukturën publike vendore, për të ofruar shërbime publike më cilësore, për të kontribuar në zbatimin e planeve të tyre strategjike dhe rritjen e kapaciteteve vendore për menaxhimin e fondeve të BE-së.





**KËSHILLI KONSULTATIV QEVERISJE QENDRORE-VENDORE
TIRANË**

ADVOKIMI I PUSHTETIT VENDOR

Bashkëpunimi ndër-institucional dhe aspekti koordinues mes pushtetit vendor dhe atij qëndror për avancimin e autonomisë vendore dhe demokracisë lokale është një objektiv strategjik për Shoqatën për Autonomi Vendore. Për këtë në veprimtarinë e saj vjetore SHAV ka zhvilluar një sërë takimesh dhe dëgjësash me pushtetin vendor, donatorët, ministritë e linjës dhe përfaqësues të tjerë të pushtetit qëndror dhe Parlamentin e Shqipërisë. Për vitin 2023 në në fokus të Shoqatës kanë qënë disa nisma ligjore dhe adresim në buxhetin shtetëror të çështjeve si:

#INSTITUCIONET

#RritjaPagavepërNivelinLokal

#TaksatVendore

#TaksatePasurisë

#Emergjencat Civile

#ArsimiParashkollor

#MenaxhimiMbetjeve

#FinancatVendore

#FondiPyjor

#RentaMinerarepërBashkitë

SHAV mbetet e angazhuar të vijojë bashkëpunimin dhe lobimin me të gjithë aktorët kryesor për më shumë autonomi, mbështetje dhe të drejta që adresojnë zgjidhje dhe përmirësojnë cilësinë e jetës së komuniteteve lokale në vend.





WESTERN BALKANS UNITE FOR SMART CITIES
PIRAMIDA, TIRANË

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Gjatë këtij viti SHAV ka marrë pjesë në një sërë takimesh dhe konferencash ndërkombëtare me fokus shkëmbimin e përvojave, tërheqjen e asistencës teknike dhe mbështetjen financiare nga projekte ndërkombëtare në fushën e pushtetit vendor, si dhe kemi ofruar kontributin tonë në hartimin e politikave dhe koordinimin rajonal me homologët tanë.

#Këshilli i Europës

Raporti i kongresit për vëzhgimin e zgjedhjeve vendore në Shqipëri në vitin 2023 vlerësoi procesin me nota pozitive duke vlerësuar zhvillimin e tij në një mjedis të qetë dhe transparent, me vend për përmirësime. Axhenda e kongresit përfshiu temat e llogaridhënies lokale, Kartën e III Urbane Evropiane (2023), tranzicionin energjetik, realizimin e SDG-ve në nivele rajonale, mediat lokale dhe angazhimin e të rinjve në pushtetin lokal. Në sesionin e 45-të të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Strasburg, Kongresi zgjodhi, z. Marc Cools, si Presidentin e ri për një mandat dy vjet e gjysmë.

#StrongCities

New York-u mblodhi kryebashkiakuet nga e gjithë bota në Konferencën “Strong Cities” e cila u zhvillua paralelisht me Mbledhje e Kombeve të Bashkuara, duke ndarë eksperiencat më të mira të zhvillimit të qëndrueshëm dhe transformimit. Në këtë konferencë nuk mungojë as bashkia Tiranë e cila përmes kryetarit të saj u përfaqësua si një model suksesi krahas qyteteve të tjera model të zhvillimit në rang global.





BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

#TranzicioniEnergjisë

Forumi i Stambollit mbi sfidat e “Tranzicionit të Energjisë” mbledhi kryebashkiakët nga i gjithë Ballkani Perëndimor të cilët nënshkruan deklaratën e partneritetit dhe vullnetetit për bashkëpunim në tejkalimin e sfidave klimatike të mijëvjeçarit të ri.



#Forcimi i Bashkëpunimit

Në Bruksel bashkë me NALAS dhe CEMR nisëm shkëmbimen e përvojave midis shoqatave të bashkive rajonale nga disa vende europiane ku në fokus do të jetë rritja e kapaciteve dhe e fondit të pagave për bashkitë tona.

#VizitaStudimore

Me përfaqësues të pushtetit vendor dhe të parlamentit britanik vendosëm piketat mbi forcimin e marrëdhënive të bashkëpunimit dhe asistencës teknike dypaleshe në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të pushtetit lokal në Shqipëri.



#Forumi i Qeverisjes Vendore

Muaji që lamë pas nisi me Forumin e Qeverisjes Vendore mbi rolin e bashkive në procesin e integritit europian duke vijuar me pritjen dhe takimet me delegacionin e Këshillit të Europës për Autoritetet Lokale dhe Rajonale.

Forumini i Qeverisjes Vendore organizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Shoqata për Autonomi Vendore në Shqipëri, me mbështetjen e projekteve të financuara nga BE, “Bashkitë për në Evropë” dhe “BE për Bashkitë” dhe NALAS ishte një mundësi e mirë për të shkëmbyer përvojat dhe sfidat në vend në prezencën e aktorëve kryesor të pushtetit vendor dhe qendror si, dhe donatorët më të rëndësishëm në vend.

Disa prej praktikave më të mira do të synojnë shkëmbimin e ideve për rolet e strukturave bashkiake dhe shoqatave në procesin e integritit europian, asistencën financiare të BE-së për pushtetin lokal, rritjen e dialogut mes autoriteteve vendore dhe bashkëpunimi për një rrjetëzim më të fortë ndërmjet pushtetit vendor në rajon e më gjerë.

Roli i SHAV është thelbësor në arritjen e qëllimit më të gjerë të përafrimit me normat dhe vlerat e BE-së, si dhe për të kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Ndaj axhenda e integritit do të jetë prioritet i Shoqatës dhe aktiviteteve të saj publike duke përfshirë kontributin tonë në funksion të zhvillimit të kohezionit rajonal, ngritjen e kapaciteteve lokale dhe lobimin ndaj autoriteteve



RAPORTE

Fushata e konsultimit publik zbatuar nga SHAV, me mbështetjen e projektit "Bashki të Forta", në kuadër të hartimit të Strategjisë së re të Decentralizimit të Republikës së Shqipërisë 2023-2030, me aktorët kryesor të pushtetit vendor në vend, prodhojë gjithashtu një sërë rekomandimesh të adresuara nga të 61 bashkitë e vendit dhe përfaqësues të pushtetit vendor. Rekomandimet e përmbledhura do t'i adresohen institucioneve përgjegjëse për hartimin e Strategjisë.

Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësisve të vetëqeverisjes vendore

Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale

Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor

Rekomandime nga Komisioni i Posacëm i Reformës Administrative Territoriale (2022)

RAPORT

Rekomandime mbi Strategjinë e Re të Decentralizimit
2023 - 2030



Përgatiti:
Shoqata për Autonomi Vendore

ky raport u
mbështet nga:



RAPORTE

RAPORT STUDIMOR PERFORMANCA E SHËRBIMEVE PUBLIKE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

2021



ANËTARËT




PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statut, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përfundimin e përvajave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot, Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrjetet më të rëndësishme të shoqatave lokale të BE dhe Europës Jug-Lindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.



Për më shumë rreth nesh ju ftojmë të lundroni në faqen tonë të web-it:

www.shav.al



Na kontaktoni:



Rruga "Brigada e VIII", Pallati 130,
shkalla 2 ap. 8, Tirana, Albania.



info@shav.al



www.shav.al



[@shoqataperautonomivendore](https://www.facebook.com/shoqataperautonomivendore)



[autonomia_vendore](https://www.instagram.com/autonomia_vendore)



SHOQATA
PER AUTONOMINE
VENDORE

Falenderojmë ekipin e Shoqatës për Autonomi Vendore (SHAV), bashkitë dhe partnerët tanë kryesorë, donatorët dhe ekspertët, dhe aktorët e tjerë të pushtetit vendor dhe qendror, të cilët me përfshirjen dhe mbështetjen e tyre në veprimtarinë sektoriale të shoqatës kanë kontribuar në mundësimin e kësaj broshure.

BASHKË PËR TË ARDHMEN E KOMUNITETIT TONË

